



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 8 Mars 2021

Nr: 117

VENDIM

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR REGJISTRIMIN E KOALICIONIT “ALEANCA BASHKIMI POPULLOR - EMIGRACIONI - ORA E SHPRESËS DHE KONSERVATORËT (ABEOK) PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN TË DATËS 25 PRILL 2021**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të neneve 65 e 66, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 2, të udhëzimit nr. 1, datë 23.12.2020, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, pasi shqyrtova kërkesën e depozituar nga përfaqësuesit e subjektit zgjedhor “Aleanca Bashkimi Popullor – Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët”, për regjistrimin e koalicionit zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin që do të zhvillohen në datën 25 Prill 2021,

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, në mbështetje të neneve 65, pikat 1 e 2, 92, shkronja “gj”, e 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 8 e 9, pikat 1 e 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me Dekretin nr. 11700, datë 06.09.2020, ka caktuar datën 25 Prill 2021 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvend.

Në mbështetje të nenit 65 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, janë regjistruar si subjekte zgjedhore për zgjedhjet për Kuvend të datës të 25 Prill 2021 pranë KQZ, partitë politike si më poshtë vijon:

- Partia Kombëtare Konservatore Albania, me Kryetar z. Kujtim Gjuzi, miratuar me vendimin nr. 66, datë 15.02.2021;
- Partia Ora e Shqipërisë, me Kryetar z. Zef Shtjefni, miratuar me vendimin nr. 29, datë 05.02.2021;
- Partia Emigracioni Shqiptar, me Kryetar z. Kostaq Papa, miratuar me vendimin nr. 35, datë 05.02.2021;



ç. Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar, me Kryetar z. Selami Jenishehri, miratuar me vendimin nr. 64, datë 15.02.2021.

Me shkresën nr. 1474 prot., datë 24.02.2021, në zyrën e protokollit të KQZ-së, partitë e sipërpërmendura, nëpërmjet kërkesës së bërë nga partia përfaqësuese Partia Kombëtare Konservatore Albania kërkojnë regjistrimin e koalicionit Aleanca Bashkimi Popullor – Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët” (ABEOK) si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës të 25 Prill 2021.

Bashkëlidhur kërkesës për regjistrimin e koalicionit “Aleanca Ora Kombëtare – Emigracioni – Bashkimi Popullor dhe Konservatorët” (ABEOK) është depozituar edhe marrëveshja për krijimin e koalicionit, në të cilën është shprehur vullneti i partive të sipërpërmendura për të qenë pjesëmarrëse të këtij koalicioni.

Marrëveshja përmban:

1. Shprehjen e vullnetit të partive pjesëmarrëse për të qenë pjesëtare të koalicionit;
2. Formimin e koalicionit me emrin “Aleanca Bashkimi Popullor – Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët”;
3. Shkronjat nistore të koalicionit “ABEOK”;
4. Siglën e koalicionit;
5. Autorizimin e z. Zef Shtjefni, kryetari i Partisë Ora e Shqipërisë të dorëzojë listat shumëmeore dhe çdo dokumentacion të nevojshëm për regjistrimin e koalicionit;
6. Autorizimin e z. Shpëtim Kodhelaj, i cili do të ketë të drejtën të përfaqësojë koalicionin gjatë procedurës së shortit në KQZ për renditjen e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bëri verifikimet përkatëse dhe konstatoi se dokumentacioni i paraqitur nga 4 (katër) partitë e sipërcituara është në përputhje me nenet 65 e 66, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe udhëzimin nr. 1, datë 23.12.2020, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”.

## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 65 e 66, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenin 2, të udhëzimit nr. 1, datë 23.12.2020, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”,



## V E N D O S:

1. Të regjistroj Koalicionin “Aleanca Bashkimi Popullor – Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët” (ABEOK) si subjekt zgjedhor pjesëmarrës në zgjedhjet për Kuvend të datës të 25 Prill 2021, me parti pjesëtare të tij, si më poshtë:
  - a) Partia Kombëtare Konservatore Albania;
  - b) Partia Ora e Shqipërisë;
  - c) Partia Emigracioni Shqiptar;
  - ç) Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

